



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. 451-8999 /2026

Klinë, datë 31/03 /2026

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, botuar në gazetën zyrtare, nr 28 më dt.04.06.2008, nenin 91 paragrafi 1 i Statutit të Komunës së Klinës të dt.07.04.2010, nenin 2 pika 2.3 dhe nenit 4 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, nr.03/L-49, dispozitat e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve dhe Transferove, nr.06-4043/2015, si dhe duke marrë parasysh kërkesën e SPAK, nr.01-451-6813/2026 të datës 06.03.2026, Kryetari i Komunës së Klinës, **mori**;

## V E N D I M

1. **LEJOHËT**, ndarja e mjeteve financiare në shumën prej **2,000.00 €** (dymijë euro) për Shoqatën Sindikale të Shërbyesve Civil në Klinë. Mjetet ndahen më qellim të realizimit të vizitës për nder të 1 majit, të Shërbyesve Civil të Administratës komunale në Klinë, sipas kërkesës, nr.01-451-6813/2026 të datës 06.03.2026. Mjetet në shumën prej 2,000.00 € paguhen nga subvencionet e zyrës së kryetarit.
2. Mjetet si nga pika 1 e këtij vendimi derdhen në xhirollogarinë e Sindikatës së Pavarur të Administratës së Kosovës, të cilat i destinohen degës në Klinë.
3. Obligohet, përfaqësuesi i Shoqatës Sindikale, qe për mjetet e ndara në shumën e lartcekur Komunës së Klinës, t'ia paraqes raportin zyrtar të shpenzimeve.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, në bashkëpunim më zyrën e kryetarit.
5. Ky vendim është i plotëfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

Të njoftohen:


- SPAK, SHSSHC- Klinë;
- DFEZH;
- Arkivi.

Kryetari  
Zenun Elezaj





**PËR:** Kryetarin e Komunës së Klinës z. Zenun Elezaj

**NGA:** Shoqata e Sindikatës së Pavarur të Administratës Klinë, kryetari. Muhamet Gashi 

**LËNDA:** K ë r k e s ë, për ndarjen e mjeteve për vizitën e punëtorëve, për shërbyesit civil të punësuar në Administratën e Komunës së Klinës.



Ju njoftojmë që shoqata sindikale e shërbyesve civil- dega në Klinë në Vazhdimin tradicional edhe këtë vit për **dt. 01 (nje) Maj** ka parapare vizitën në Shqipëri, prandaj për realizimin e kësaj vizite nevojitet edhe ndihma financiare e zyrës së Kryetarit të Komunës së Klinës z. Zenun Elezaj

Kërkojmë nga kryetari i Komunës së Klinës që të na ndihmoj me një shumë të mjeteve në vlera prej **3500 euro**, kjo ndihma nga ana e juaj do të na mundësojë këtë vizitë të punëtorëve që ka domethënë të madhe për punëtorët e komunës sonë.

Besojmë fuqishëm në vlerësimin tuaj në raport me këtë kërkesë duke vlerësuar që kryetari do ta mbështete dhe përkrah këtë kërkesë të drejtë dhe të arsyeshme të punëtorëve.

**Me respekt,**

**Klinë, më 06.03.2026**

**21 Nr. 651-6813 /2026**